



INSTITUCIONET E PËRKOQSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE SAMOUPRAVNE INSTITUCIJE
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
Ministry of Education, Science & Technology
Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku i Tehnologiju

UDHËZIM ADMINISTRATIV

LËNDA: Kalendaari për vitin shkollor 2002/2003

NUMËR: MASHT (I) 11/2002

DATË: 23 gusht 2002

Në përputhje me Rregulloren nr.2001/19 të dt, 4 tetor 2001 të Degës të Institucioneve Kalimtare të Vetqeverisjes në Kosovë, Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë lëshon këtë Udhëzim Administrativ.

Paragrafi 1

Viti shkollor

- 1.1. Viti shkollor akademik 200/2003 do të fillojë më 2 shtator dhe dotë përfundojë më 31 gusht 2003.
- 1.2. Semestri i parë i vitit shkollor dop të fillojë më 2 shtator 2002
Semestri i parë i vitit mësimor do të përfundojë më 20 dhjetor 2002
Semestri i dytë i vitit shkollor do të fillojë më 13 janar 2003
Semestri i dytë i vitit mësimor do të përfundojë në ato data që janë të zbatueshme për vitet përkatëse siç përcaktohet me paragrafin e dytë të shënuar më poshtë.

Paragrafi 2

Kohëzgjatja e secilit vit

- 2.1 Vitet prej I – VIII do ta përfundojnë vitin mësimor më 13 qershor 2003. Kështu do të kemi vitin mësimor me 37 javë apo 185 ditë mësimi.

2.2 Viti i IX, sikurse edhe viti i II dhe III të shkollës së mesme do ta përfundojnë vitin mësimor më 30 maj 2003. Kështu do ta kemi vitin mësimor me 35 javë apo 175 ditë mësimi.

2.3 Viti i IV apo viti përfundimtar i shkollave të mesme do ta përfundojë vitin mësimor më 9 maj 2003. Kështu do të kemi vitin mësimor me 32 javë apo 160 ditë mësimi.

2.4 Pëveç ditëve të përmendura nga të gjitha vitet kërkohet ti realizojnë edhe 10 ditë tjera pune siç është e përcaktuar me paragrafin 3.

Paragrafi 3 **Ditët e punës**

3.1 Gjatë vitit shkollor nga të gjitha shkollat kërkohet t'i realizojnë nga 10 ditë pune të shtunave për aktivitete të ndryshme shkollore, ku përfshihen, po jo edhe të jenë të kufizuara, ngjarjet si aktivitete kulturore, sportive dhe shetitje të organizuara nga shkollat.

3.2 “Ditët e punës” janë të renditura në listën e bashkangjitur në këtë Udhëzim.

Paragrafi 4 **Aktivitetet praktike**

4.1 Përveç mësimin në klasë do të ketë edhe forma tjera mësimi siç është mësimi praktik dhe stërvitja profesionale.

4.2 Në fillim të vitit shkollor secila shkollë është përgjegjëse që në kalendarin e vet shkollor t'i bashkangjet aktivitetet e tilla.

Paragrafi 5 **Festat publike**

5.1 Të gjitha shkollat nuk do të punojnë në këto festa publike:

28 nëntor 2002	Dita e Flamurit
05 dhjetor 2002	Bajrami i Madh
11 shkurt 2003	Bajrami i Vogël
21 prill 2003	Pashkët
01 maj 2003	1 Maji

Paragrafi 6
Legjenda e kalendarit shkollor

6.1 Kalendarit shkollor për gjithë Kosovën për vitin akademik 2002/2003 I bashkangjitet këtij Udhëzimi si një listë e ndarë.

6.2 Legjenda e kalendarit shkollor është si vijon:

- a – Përfundimi i mësimit për vitet I-VIII
- b – Përfundimi i mësimit për vitet IX dhe II e III të shkollës së mesme
- c – Përfundimi i mësimit për vitin IV apo vitin përfundimtar të shkollës së mesme
- ç – Përfundimi i gjysmëvjetorit të parë
- d – Fillimi i gjysmëvjetorit të dytë dytë
- e – Festat

Paragrafi 7
Hyrja në fuqi e këtij Udhëzimi Administrativ

7.1 Ky Udhëzim do të hyjë në fuqi më 23 gusht 2002

Rexhep Osmani
Ministër i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë